

**PROGRAMI PËR
HULUMTIME DHE
PUBLIKIME**

Programi për Hulumtime dhe Publikime

Akademia e Drejtësisë në përmbushje të mandatit të saj ligjor për zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përveçhartimit të programit trajnues dhe organizimit të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve tjerë të sistemit të drejtësisë, kryen edhe analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese në përmbushje të nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira. Këtë funksion ligjor Akademia e Drejtësisë e realizon përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime.

Gjatë vitit 2018, Programi për Hulumtime dhe Publikime do të fokusohet në komponentët e saj siç janë: hulumtimet, publikimet dhe qasja në burimet ligjore përmes bibliotekës së Akademisë.

Qëllimi i PHP-së:

- Sigurimi dhe ofrimi i burimeve ligjore të nevojshme për përfituesit e vet;
- Krijimi i burimeve të reja juridike varësisht nga nevojat e gjyqësorit;
- Realizimi i hulumtimeve për zhvillimin e programeve trajnuese të Akademisë;
- Përmirësimi i cilësisë së botimeve dhe publikimeve shkencore; si dhe
- Inkurajimi dhe përfshirja e komunitetit ligjor veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit në publikime shkencore;

4.1 Hulumtimet

Hulumtimet gjatë vitit 2018 do të jenë të përkushtuara në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të programeve trajnuese, si dhe për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve trajnuese do të realizohen:

- Analiza të programeve të vlerësimit pas sesioneve trajnuese, pyetësorëve në gjykata dhe prokurori, që do të ketë në fokus, profilin, metodologjinë e trajnimit, përmbajtjen dhe çështjet tjera organizative;
- Analiza e strategjive, raporteve të ndryshme të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë;
- Hulumtime rreth problemeve praktike të cilat mund të adresohen qoftë përmes trajnimeve ashtu edhe përmes krijimit dhe zhvillimit të mjeteve juridike;
- Hulumtime sipas nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit;

Këto analiza dhe hulumtime të cilat realizohen përmes këtij programi do të jenë ndihmesë dhe kontribuese në zhvillimin dhe avancimin e programit trajnues për vitin 2019 që do të jetë adekuat me nevojat reale dhe i cili do të ndikojë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori.

4.2 Veprimtaria botuese – publikimet

Komponentë e rëndësishme e këtij programi është veprimtaria botuese e cila është e orientuar në publikimet në fushën juridike, veçanërisht në lëmin e gjyqësorit për të kontribuar në zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Në publikimet e Akademisë do të angazhohen ekspertë të fushave të ndryshme të së drejtës për të dhënë ekspertizën e tyre qoftë në revista, module trajnuese dhe materiale tjera ligjore përmes të cilave do të ndikohet në pasurimin e kulturës juridike me njohuri praktike dhe teorike.

Publikimet e Akademisë synojnë që të jenë burim informimi veçanërisht me praktikën gjyqësore dhe risitë në legjislacion dhe në përgjithësi në lëmin e drejtësisë si dhe informues për aktivitetet trajnuese të Akademisë.

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2018 planifikon ti realizoj këto publikime:

Në kuadër të revistave:

1. **Revista “Opinio Juris”**- tashmë e konsoliduar si revistë e gjithë profesionistëve ligjor, e cila do të vazhdojë të nxisë komunitetin ligjor në publikimin e rezultateve hulumtuese, veçanërisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit. Kjo revistë do të jetë një literaturë shtesë dhe lehtësuese veçanërisht për gjyqtarë dhe prokurorë e shtetit.
2. **Revista Justicia** - Kjo revistë do të përmbledhë punimet e gjyqtarëve të sapoemëruar të gjeneratës së VI të cilët vijojnë trajnimet në Programin e Trajnimit Fillestar.

Në dobi të nxjerrjes së këtyre dy revistave do të vazhdojë të veprojë dhe funksionojë Këshilli i Redaksisë i cili do të kujdeset që këto revista të jenë të cilësisë së lartë dhe në pajtim me standardet evropiane si dhe burim i rëndësishëm për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor.

Në kuadër të moduleve trajnuese:

1. **Modulet trajnuese në PTF për prokurorë të sapo emëruar**- janë përmbledhje e kurseve trajnuese të cilat realizohen në kuadër të këtij programi trajnues. Sipas nevojës së përfituesve janë të mundshme edhe ribotimi i moduleve aktuale.
2. **Modulet trajnuese për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive** - janë përmbledhje e nënmoduleve të cilat trajtojnë aspekte profesionale dhe interdisiplinare për këto kategori.

Në kuadër të publikimeve të cilat janë me karakter informues për aktivitetet e Akademisë:

1. **Raporti vjetor** i cili pasqyron aktivitetet e Akademisë-së brenda vitit 2017;
2. **Programi i Punës për vitin 2019** i cili përmban aktivitetet e Akademisë që do të realizohen gjatë vitit 2019;
3. **Programi Trajnues për vitin 2019** që reflekton nevojat e gjyqësorit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe profesionistëve tjerë ligjor;
4. **Buletini mujor**-do të vazhdojë të publikohet në baza mujore dhetë pasqyrojë aktivitetet e Akademisë së brenda muajit.

4.3 Biblioteka

Sigurimi dhe ofrimi i burime ligjore për gjyqtarët, prokurorët e shtetit dhe profesionistët e tjerë ligjor do të bëhet përmes aktiviteteve të bibliotekës e cila edhe gjatë vitit 2018 do të vazhdojë me pasurimin dhe menaxhimin e koleksioneve të saj.

Në kuadrin e aktiviteteve të bibliotekës do të vazhdohet me:

- Identifikimin e titujve të ri në fushën juridike dhe sigurimin e tyre për bibliotekën e Akademisë;

- Njoftimin e rregullt të përfituesve me materialet e reja ligjore që posedon biblioteka e Akademisë;
- Katalogimin dhe klasifikimin e materialeve të reja ligjore;
- Qarkullimin e materialeve ligjore për përdorim jashtë bibliotekës;
- Skanimi i titujve të librave fizik dhe publikimi i tyre në bibliotekën elektronike për të dhënë informacion më të detajuar për përmbajtjen e tyre;
- Ofrimit të qasjes në disa data baza të ndryshme ligjore deri në korrik 2018, si dhe me vazhdimin e anëtarësimit në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike.